



Universiteti i Tetovës

Fakultetit të Kulturës Fizike

Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Tetovës

Në bazë të vendimit të Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Tetovës nr. 19-141/4 nga mbledhja e mbajtur më 17.10.2019 për formimin e Komisionit për vlersimin e Disertacionit të doktoraturës me titull „ **Zhvillimi i disa aftësive kondicionale te Atletet dhe Karatistët e rinj te moshave 10 - 12 vjec dhe 12 - 14 vjec gjatë procesit stërvitor një vjeçar**, të kandidatit Mr.sc. Alim Hajredini . Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Tetovës formon komisionin nga pesë antarë në përbërje:

Prof. Dr. Visar Ganiu - mentor,

Prof. Dr.Vullnet Ahmeti - anetar,

Pro. Dr. Bexhet Toçi - anetar,

Prof. Dr. Fadil Nika - anetar dhe

Prof. Dr. Fadil Rexhepi - anetar.

Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Tetovës paraqet këtë raport.

Raport

Për vlersimin e disertacionit të doktoraturës

Mr.sc Alim Hajredini i lindur në f. Ladorisht, të qytetit të Strugës në Republikën e Maqedonisë Veriore, shkollimin fillor mbaroi në vendlindje, ndërsa të mesmen në Prishtinë. Studimet deridiplomike katër vjeçare i mbaroi në Institutin e Lartë të Edukimit Fizik - Tiranë, po ashtu edhe studimet postdiplomike të magjistraturës në Akademin e Edukimit Fizik – Tiranë.

Veprimtaria pedagogjike e Mr.sc. Alim Hajredinit fillon në vitet 1997 kur edhe punësohet si asistent i Atletikës në fakultetin e Kulturës Fizike, ku edhe sot vazhdon me punën e pedagogut . Shkollën fillore në vendlindje, atë të mesme në Prishtinë. Fakultetin e Kulturës Fizike në Prishtinë 1993-1995, dhe për të përfunduar në Institutin e Lartë të Edukimit Fizik “VOJO KUSHI” në Tiranë 1995-1997 i specializuar në Atletikë. Studimet posdiplomike në Akademin e Ed. Fizik “V.KUSHI” Tiranë 2002-2004 drejtimi - Atletikë.

Prej vitit 1989 mireme sportin e Atletikës dhe të Karatesë, kam marrë pjesë në shumë gara brenda dhe jashtë vendit. Prej vitit 1999 e deri më sot udhëheq Klubin e Karatese “Drini” në Strugë, ndërsa nga viti 2009 dhe klubin e Atletikës “DRINI” Strugë. Si sportist kam arritur të fitoj shumë mirnjohje, diploma dhe medalje në rrafshin Kombëtare dhe atë Ndërkombëtare si në Karate ashtu edhe në Atletike.

Veprimtaria shkencore

A.Хайредини - Некои мерни карактеристики на три теста за проценување на експлозивна сила. Дојран(2011) **A.Хайредини – Мерни карактеристики на композитни мотрни тестови за проценување на рамнотежа.** Дојран(2011)

A.Хайредини – Пеливанство – Народна борба. Шумен (2011)

A.Хјаредини – Маркетинг и негови дејности.(2011)

A.Хјаредини – Маркетинг и негови дејности.(2011)

A.Хайредини, Б.Телаи, М.Далип, А.Адеми, Х.Исмаили – Реконструкција на предниот вкрстен лигамент и важноста на проприорецепцијата при враќањето во спортот. Скопје (2009)

A.Хайредини, Б.Саити, А.Мустафа – Организација и развивање на тренажниот процес во основната фаза на долгогодишното делување во атлетика. Пелистер (2008)

A.Хайредини, Л.Мемеди, Ф.Ника – What School Children at Eight Grade from Struga Feel About their Teacher in Physical Education and the Subjekt. Sofia (2012).

Л.Мемеди, Ф.Ника, А.Хајредини - СТАВОТ НА УЧЕНИЦИТЕ ЗА НАСТАВАТА ПО ПРЕДМЕТОТ ФИЗИЧКО И ЗДРАВСТВЕНО ОБРАЗОВАНИЕ , Veliko Trnovo (2011)

Л.Мемеди, Ф.Ника, А.Хајредини - Pupils' attitude towards the teacher in physical education ,RUSENSKI UNIVERSITET (2011)

Б.Саити, А.Хајредини, А.Адеми – Антропометриските карактеристики и моторните способности кај учениците и ученичките на 17 годишна возраст. Пелистер (2008)

Х.Исмаили, М.Далип, А.Адеми, Б.Саити, Б.Телаи, А.Хајредини – Програма за спречување на појавата на повреди кај фудбалерите F-Mare 11 и F-Mare 11+. Скопје(2009)

Б.Телаи, М.Далип, А.Адеми, А.Хајредини, А.Абдулаху – Анализа на некои технички и тактички вредности на репрезентациите кои играа полуфинале и финале на светското првенство во фудбал / 2006 година. Скопје(2009)

Н.Рашиќи, В.Ајвази, А.Нура, А.Хајредини – Influence of body height, bodz weight and the age on the results achieved bz men-marathoners in a marathon race. Podgorica.(Montenegro 2011)

Fadil Nika, Bexhet Toci, Dushko Jakovcevski, Alim Hajredini – Ефективност на сестмесецена тренировка програма върху специфичните двигателни меню при 12-годишни баскетболисти (Bulgaria 2015)

Bexhet Toci, Alim Hajredini, Orges Licaj – Strength and its structure at students of physical education os State University of Tetova.(Tirana – Albania 2017)

Alim Hajredini – The role of athletics in the development of motor skills.(Tetovo)

Alim Hajredini – Motor transformation and development of young athletes during aschool year. (Skopje 2018)

Bexhet Toci, Alim Hajredini – Treatment of children with special needs and opportunities for their involvement in sports activities. (Tetovo 2018)

Fadil Nika, Naser Rashiti, Labinot Ramadani, Alim Hajredini – The influence of different anthropometric dimensions in short sprints.(Tetovo 2018)

Në Disertacionin e tij të Doktoraturës me titull „ Zhvillimi i disa aftësive kondicionale te Atletet dhe Karatistët e rinjë te moshave 10 - 12 vjeç dhe 12 - 14 vjeç gjatë procesit stërvitor një vjeçar.

Kjo temë është përzgjedhur për më shumë arsye të cilat do të tentojmë ti zbërthejmë në këtë disertacion. Procesi stërvitor me këto grup moshë është më shumë se sfidues nga shumë aspekte dhe atë në aspektin e zhvillimit motor nga aspekti shumdimenzional të aftësive

kondicionale dhe specifikat e shumta të kësaj grupmoshe, e cila ka disa karakteristika zhvillimore, shëndetësore, sociale dhe psikologjike.

Kjo moshë është studiuar nga shumë studiues që merren me studimin e aftësive funksionale, fiziologjike, kondicionale. Trajnimin e kësaj moshe, ku kjo moshë është shumë e luhatshme jostabile si moshe e femijerisë dhe moshë e parapubertetit. Mostra e përzgjedhur e këtyre sportistëve i është nënshtruar një procesi mjaft të rregullt gjatë gjithë kohës.

Në këtë studim merren në proces të studimit dy grupe të sportistëve që jetojnë dhe veprojnë në dy qytete të ndryshme, në Tetovë atletet e klubit atletik "Studenti" dhe atletët (karatistë) të klubit "Drini" Strugë. Moshja e tyre është e përputhshme me kategorinë e fëmijerisë së vonshme dhe atë të parapubertetit 10-12 vjet dhe 12-14 vjet. Sa i përket këtyre dy grupeve të moshave homogjene nga aspekti gjinor dhe moshës por duke qenë të dallueshëm nga aspekti i disiplinave sportive të ndryshme Karate dhe Atletikë.

Në ekipin e moshave të KA "Studenti" në studim përfshihen 40 nxënës të cilët mbas kontroleve mjeksore nuk kanë probleme shëndetësore dhe pjesa më e madhe e tyre është në proces stërvitor më shumë se një vit kalendarik.

Në ekipin e moshave në KK "Drini" Strugë po ashtu numri i atletëve që do të përfshihet në studim është 40, atletët të cilët janë në proces stërvitor më shumë se dy vite, mbas kontrollit mjeksor nuk kanë probleme shëndetësore. Të dy grupet kanë numër të barabartë garuesish dhe punojnë në kushte të ngjajshme sa i përket objekteve sportive të cilat procesin stërvitor e realizojnë në palestra gjatë sezonit dimëror dhe jashtë në natyrë gjatë sezonit veror, kur kushtet atmosferike janë të përshtatshme dhe të mundshme për tu realizuar procesi stërvitor.

Në këtë studim i cili është realizuar me sukses duke u përmbajtur me përpikmëri idesë dhe projektit bazë duke u munduar që të jemi sa më të besueshëm, është marrë parasysh jo vetëm procesi stërvitor që realizohet gjatë kohës prej një viti, ku në vijim është bërë kontrolli dhe mbajtja e stërvitjeve.

Kërkimet shkencore, që janë arritur deri më sot në këtë kategori moshe dhe në këto disiplina sportive, na kanë ndihmuar për të qenë sa më të besueshëm dhe konsekuent në dokumentimin e rezultateve të arritura në fazën e parë kontrolluese dhe në përfundim të vitit të procesit stërvitor. Aftësitë kondicionale motore si dhe aftësitë antropologjike bazike, janë sfida permanente për gjithë studiuesit e hapsirës motore dhe asaj antropomotore, raportet e këtyre dy hapsirave, e në veçanti studimet jo shumë të mëdhaja nga kjo moshë për shkak të ndryshimeve të mëdhaja dhe të shpejta të karakteristikave të moshës së paracaktuar që na shton kureshtjen më të madhe për këtë studim me të cilin duam të japim kontributin tonë modest në shkencën e motorikës dhe zhvillimit të moshave të reja.

Për kontrollin e aftësive kondicionale motore, kemi vendosur të aplikojmë testet e Eurofitit të modifikuar për këtë grup moshe. Testi i eurofitit i modifikuar është aplikuar në disa punime të

cilat kanë hapur shumë dilema krahas studimit të një game të gjërë të shkathtësive dhe aftësive motore. Për kontrollimin e aftësive antropologjike kemi marrë testet bazë, peshën, gjatësinë dhe Bodi Mas Indeks (BMI).

Qëllimi i këtij studimi është të marrë në konsideratë dhe studiojë zhvillimin e aftësive kondicionale motore, duke parë dhe studiuar problematikat dhe përparsitë e mundësive të zhvillimit të fëmijëve që meren me sport, atë të atletikës dhe karatesë. Kontrolli i zhvillimit të aftësive kondicionale si bazë për të zhvilluar shkathtësitë lëvizore të fëmijët e kësaj moshe për të pasur një pasqyrë më të qartë orientimin ose specializimin.

Testet e Eurofitit të modifikuara për moshat e reja do të dedektojnë Hapsirën Latente motore të aftësive kondicionale motore bazike dhe ndikimi i tyre në realizimin e shkathtësive dhe rezultatet në sportet përkatëse. Bateria e testeve motore që ka aplikuar gjatë studimit mendojmë se do zërthejë gjendjen initiale të aftësive kondicionale, do përcjellë edhe zhvillimin e aftësive kondicionale nëpër matjet kontrolluese të cilat do të realizohen në fillim të procesit stërvitor kontrolli i parë dhe kontrolli në përfundim të studimit.

Mbas mbledhjes së rezultateve dhe analizimit të tyre me metodologjitë e analizës numerike dhe metodologjive, tema e këtij studimi do të jetë statusi Antropologjik dhe relacionet e karakteristikave antropologjike me ato kondicionale në secilin grup, pra ndaras nëpër dy klubet dhe relacionet e zhvillimit nëpër dy kontrollet si dhe zhvillimi i këtyre raporteve në mes të grupeve. Karakteristikë e veçantë do jetë puna që do bëhet në procesin stërvitor e cila do jetë inkluzive mes dy gjinive, numri i vajzave dhe djemve është proporcional. Puna e njëjtte në këtë moshë është e mundur për shkak të karakteristikave të ngjashmerive zhvillimore të fëmijëve të kësaj moshe .

Nga aspekti i rëndësise dhe i benifiteve që do të ketë ky studim shkencor. që të dedektojë ndikimin e procesit stërvitor, që zgjati tre herë nga një orë efektive në javë, ku stërvitet janë mbajtur nga ora 18 deri në ora 19, ditëve të hënë, të mërkurë dhe të premte, ditët e shtuna dhe e diela, në të shumtën e rasteve janë ditë ku fëmijët merren me garat që organizohen nga klubi dhe nga federatat përkatëse. Atletët marrin pjesë rregullisht nëpër këto gara.

Gjatë procesit stërvitor kemi kontroll të herë pas herëshëm të aftësive kondicionale dhe shkathtësive motore të realizuara. Duke studiuar kërkimet e fundit në këtë fushë studimi të zhvillimit të aftësive kondicionale, atletët kanë marrë një trajtim të avancuar të bazuar mbi të dhënat shkencore të transformimit të aftësive kondicionale si: forca e fuqia, fleksibiliteti, shpejtësia, agiliteti dhe qëndrueshmëria, cilësi kondicionale këto të cilat në kushte të veçanta në kohë dhe gjatësi kohore, kanë avancime të ndryshme si cilësi kondicionale të veçanta dhe aftësi kondicionale, që veprojnë bashkë në ndërveprim perfekt mes dy apo më shumë aftësive të cilat ndërveprojnë njëra me tjetren, në mvarhtësi të realizimit të shkathtësive dhe detyrave motore komplekse.

Disertacioni i doktoraturës së Mr.sc Alim Hajredini është i strukturuar në VII kapituj.

Kapitulli i -I- trajton qëllimin dhe argumentimin e përzgjedhjes së temës së Disertacionit, rëndësinë e studimit shkencor, analizimin dhe shtjellimin e problematikave të aftësive kondicionale dhe antropometrike në përgjithsi dhe në veçanti të këtyre grupmoshave. Në këtë studim i jepet një paraqitje e studimeve kërkimore e deritanishme të fushës që ne kemi marrë në studim.

Kapitulli i -II- ka si qëllim të argumentojë studimin të realizuar, ky studim u realizua sipas projektit ideor të miratuar nga këshilli mësimor, pa pasur nevojë të ndryshimeve thelbësore gjatë eksperimentimit. Eksperimenti u realizua sipas planifikimit, me ekipe të trajnuara paraprakisht për tu realizuar eksperimenti, matja e parë u realizua sipas projektimit në orët dhe ditët kur edhe mbahej procesi stërvitor. Të dy grupet ju nënshtruan të njëjtat teste dhe nga i njëjti ekip i testimit i cili u trajnua enkas për këtë eksperiment.

Kapitulli i -III- parashih të realizojë me përpikmëri detyrat shkencore dhe profesionale, duke ruajtur vlefshmërinë e eksperimentit si nga aspekti teorik dhe nga aspekti i realizimit praktik. Gjatë eksperimentit ka pasur përqëndrim që rezultatet e fituara të jenë të evidentuara me përpikmëri dhe të verifikuar nga udhëheqsi i eksperimentit, në këtë rast nga kandidati në kërkim të gradës dhe mentori dhe udhëheqsi shkencor. Instrumentet janë të besueshëm dhe të vlersuar, të balansuar dhe kontrolluar. Ka pasur kujdes gjatë eksperimentit të gjithë sportistët të marrin pjesë nga 95% deri 98% në procesin stërvitor. Njëkohësisht është bërë kujdes që gjendja shëndetsore të jetë nën kontroll dhe ka qenë e mirë.

Kapitulli i -IV- parashih realizimin e metodologjive të punës eksperimentale dhe shkencore, si dhe metodologjinë e përpunimit statistikor me metodologjitë më të reja që aplikohen për këtë lloj kërkimi shkencor. Rezultatet përpunohen me programin SPS 15, ku mbi analizën bazike të statistikave të mesatares statistikore është kontrolluar mesatarja statistikore, devijimi standard, vlerat maksimale dhe minimale në grupe, devijimi standard, skewnes dhe kurtosis vlera këto që përshkruajnë dendësinë dhe shpërndarjen, e secilit grup ndaras sipas disiplinës dhe sipas gjinisë, këto rezultate janë paraqitur në 17 tabela të veçanta të cilat paraqesin strukturën latente e cila po spjegohet me interpretimin profesional dhe shkencor të kandidatit. Analiza e tillë është bërë edhe për rezultatet e matjeve initiale edhe për rezultatet finale. Më tej është shkruar me analizën e Multivariantës Manova dhe analizën e variantës Anova të subjekteve, si grupin e atletëve dhe atleteve po ashtu edhe grupin e karatistëve dhe karatisteve, si dhe analizat e të njëjtave veçmas për moshat 10 -12 dhe 12-14, njëkohësisht edhe mbi bazën e grupeve. Gjithashtu edhe këto analiza janë bërë për rezultatet initiale dhe finale të përfshira në 28 tabela . Është bërë edhe Analiza e Korelacioneve, mes grupeve dhe mes gjinive ku kjo pjesë është zbrëthyer në 18 tabela të korelacionit të testeve Antropometrike dhe testeve Motorike.

Kapitulli i -V- që përfshin Hipotezat e hulumtimit dhe efektet që dalin nga ky studim për shkencën e Kineziologjisë, sipas analizës së rezultateve në bazë të analizave më të avansuara të kohës, rezultatet sjellin mjaft informacione të vlefshme që do të zgjojnë karshërinë shkencore duke u përdorur më tej për studime më të thelluara në këtë popullatë të nxënësve dhe sportistëve.

Sa i përket hipotezave të hulumtimit, mundemi të themi se janë realizuar plotësisht kur bëjmë analizën statistikore të avansimit sa i përket zhvillimit motor të aftësive kondicionale si shpejtësia, forca, qëndrueshmëria specifike dhe speciale, fleksibiliteti bazik, ndërsa sipas pritshmërive rezultatet antropomoteore kanë një rritje normale që nuk bën diferencë nga popullatat e ngjajshme të kësaj grupmoshe, kjo grupmoshë dallohet për diversitet të zhvillimit sidomos për shkak të parapubertetit dhe pubertetit, që varion në vartësi të gjenotipit dhe fenotipit. Kjo moshë është mjaft e sensibil nga aspekti emocional dhe psikosocial, ku sporti i bën grupe të dallueshme dhe homogjene në krahasim me si moshatarët e vet.

Hipotezat e parashtruara janë katër dhe të gjitha mbi bazën e leximit të rezultateve të katër hipotezat e këtij studimi janë arritur dhe nga kjo vijmë në konkludim, se idea dhe realizimi i këtij studimi, është i arirë dhe i ploteson kushtet që të quhet studim i mirefilltë shkencor .

Kapitulli i –VI- Përfshin Metodologjinë e punës eksperimentale shkencore, të realizuar si gjatë realizimit të eksperimentit po ashtu edhe për realizimin e procesit stërvitor, rregullshmërisë së subjekteve në këte rast, nxënësve dhe trajnerëve që kanë pasur vëmendjen e disertantit gjat gjithë vitit, me qëllim të realizimit sa më korrekt nga aspekti shkencor dhe shume të saktë profesionalisht, kjo metodologji pune, ka sjellur rezultate të prekshme edhe në planin e përgjithshëm dhe në planin individual, pasi këto fëmije, përveç se kanë pasur një trajnim profesionalisht të mirë organizuar, ku kanë arritur ndryshime thelbësore të aspektit somatik, por kemi edhe ndryshime të statusit motor thelbësor dhe mbi këtë bazë, kemi edhe avansim në garat ku këta fëmijë në disiplinat ku kanë bërë gara, kanë marrë një numër të madh të medaljeve dhe kupave në garat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kapitulli i -VII- Kryesisht merret me spjegimin dhe reflektimin në pritshmëritë e rezultateve të sportistëve, në planin antropomotor dhe psikomotor, respektivisht në aftësitë kondicionale motore, ku rezultatet e interpretuara na japin shume informacione dhe sygjerime, të cilat do ti hyjnë në punë interpretimit shkencor dhe profesional, të gjithë pedagogëve dhe shkencetarëve të ardhshëm që do të merren me këtë hapësirë, qoftë ajo motore, po ashtu edhe ajo antropometrike.

Përfundimi dhe propozimi i komisionit

Disertacioni i doktoraturës me titull „**Zhvillimi i disa aftësive kondicionale te Atletet dhe Karatistët e rij te moshave 10 - 12 vjeç dhe 12 - 14 vjeç gjatë procesit stërvitor një vjeçar**” i kandidatit Mr.sc. Alim Hajredini, paraqet një studim shkencor dhe profesional në fushën e hapsirës së zhvillimit dhe rritjes të aftësive psikomotore dhe kondicionale në veçanti gjatë një viti. Ky studim është një studim i aspektit horizontal i cili i mungon hapsirës studimore në vend dhe më gjërë, përparësi e këtij studimi është se kandidati në kërkim të gradës shkencore doktor të shkencave Kineziologjike, ka qenë protagonist edhe i procesit stërvitor dhe ka udhëhequr punën nga afër të këtyre nxënësve, duke u ambientuar dhe duke i ndëgjuar të gjitha kërkesat dhe duke u përballur me problematikat thelbësor që kanë këto sporte në zhvillimin dhe rritjen e fëmijve dhe zhvillimin e tyre ne njerëz dhe sportistë kulminant, nga këto atletë dy prej tyre janë edhe reprezentues edhe bursistë edhe kandidatë për lojrat olimpike 2024 të financuar nga projekti për Rini nga agjensioni për sport i RMV.

Nga vlersimi i sipër përmendur, komisioni për vlersimin e disertacionit të doktoraturës me titull „**Zhvillimi i disa aftësive kondicionale te Atletet dhe Karatistët e rij te moshave 10 - 12 vjeç dhe 12 - 14 vjeç gjatë procesit stërvitor një vjeçar**” të kandidatit Mr.sc. Alim Hajredini, konstaton se disertacioni i plotëson te gjitha kriteret e përcaktuara dhe i propozon këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Tetovës që të miratojë këtë raport dhe njëkohësisht të lejojë për mbrojtje publike .

Komisioni 1. Prof. Dr. Visar Ganiu - mentor

2. Prof. Dr. Vullnet Ahmeti - anëtar

3. Prof. Dr. Bexhet Toçi - anëtar

4. Prof. Dr. Fadil Nika - anëtar

5. Prof. Dr. Fadil Rexhepi - anëtar

